



Pranuar me: Primitjenë:	07 05	20 21
Njësia Jadhica	Numri Brej	Shtojca Dodatak
15-600-22808		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPIAN

Bazuar në dispozitat e neneve 12 paragrafi 12.2 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, , si dhe neneve 9, 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 07.05.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E PRIORITETEVE PËR PROJEKTET KAPITALE PËR GRANTIN E PËRFORMANCËS KOMUNALE

Neni 1

Me këtë Vendim , Kuvendi i Komunës së Lipjanit, **APROVON**, listën e projekteve kapitale që do të realizohen nga bashkëfinancimi në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Grandit të Përformancës Komunale (GPK).

Neni 2

Lista e Projekteve kapitale, përfshinë projektet si vijon:

1. Ndriqim publik në Shalë dhe Krojmir,
2. Ndriqimi publik në Ribar të Madh dhe Zllakuqan,
3. Ndriqimi publik në Kraishtë,
4. Ndriqimi publik - faza e dytë në Smallushë,
5. Ndriqimi publik në Janjevë,
6. Ndërtimi i rezervuarit të ujit dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Janjevë,
7. Asfaltimi i rrugicave në Glllogoc,

Neni 3

Shuma e mjeteve nga Granti i Përformancës Komunale (GPK) do të jetë 320,634.00€, (treqind e njëzetmijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër euro), ndërsa shuma e mjeteve nga Komuna e Lipjanit do të jetë 111,365.95€ (njëqindë e njëmbdhjetëmijë e tretëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro nëntëdhjetë e pesë cent).

Neni 4

Autorizohet, Kryetari i Komunës që duke u bazuar në dispozitat e këtij Vendimi, gjatë aplikimit për fonde të nxjerr Vendime të veçanta për aprovimin e secilit projekt nga lista e projekteve të cekura në nenin 2 të këtij Vendimi. Vendimet e veçanta nxirren në momentin e krijimit të kushteve për aplikim për projektin/projektet përkatëse .

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

15Nr. _____

Lipjan, më 07.05. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

